



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184195  
Më 18.10.2016



**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për trajnim për rikthimin e zejeve të zhdukura tradicionale, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e organizimit të trajnimit për rikthimin e zejeve të zhdukura tradicionale, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt është i planifikuar me kod buxhetor.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184198  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit për shenjzimin dhe evidentimin e tabelave në Zonën Historike”, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e hartimit të projektit për shenjzimin dhe evidentimin e tabelave turistike në Zonën Historike”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt është i planifikuar me kod buxhetor.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184198  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për dekorimin e qytetit për festat e fundvitit, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e dekorimit të qytetit me pajisje dekorative për festat e fundvitit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt realizohet prej kodit buxhetor-mallra dhe shërbime.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184213  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për formimin e Komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave nr. 01/011-31308 datë 19.9.2015, kryetari i Komunës, me 4 tetor 2016, mori këtë:

### AKTVENDIM Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave nr. 01/011-31308 datë 19.9.2015. Anëtarë të këtij komisioni emërohen:
  - 1.1. Muhamet Bajrami, kryesues,.....DShP (SMM),
  - 1.2. Nezir Rexhepi.....DShP, (SMM),
  - 1.3. Islam Osmankaj,.....DEF,
  - 1.4. Arben Shala,..... DUPH,
  - 1.5. Ramadan Tafallari,..... DShP (SA),
  - 1.6. Zenel Ahmetaj,..... DEF,
  - 1.7. Laura Suka,.....DShP (SMM), anëtar.
2. Detyra e komisionit është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj draftin e plotësuar dhe ndryshuar të rregullores për menaxhimin e mbeturinave, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe pas hartimit të draftit përkatës, i njëjti i procedohet organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
4. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, kryesuesi dhe të emëruarit.
5. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184219  
Më 18.10.2016



**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Gjermanisë dhe pagesës së mëditjeve për Islam Elshanin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Islam Elshanit, zyrtar komunal, për në Republikën e Gjermanisë, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore lidhur me përfshirjen e aktorëve relevant nga institucionet partnere të projektit rajonal “Përfshirja sociale për grupet në nevojë”. Vizita studimore do të realizohet nga data 30 tetor 2016 deri me 4 nëntor 2016, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184224  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për OJQ “Equaltyti”, kryetari i Komunës, më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për OJQ “Equaltyti”, për realizimin e projektit: “Pjesëmarrja e të rinjve të të gjitha komuniteteve në mekanizmin e sektorit të sigurisë“, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumë prej 1900 €.
2. Ky projekt realizohet nga OJQ “Equaltyti”, në bashkëpunim me Drejtorinë për Emergjencë dhe Siguri, KKSB, Policinë e Kosovës, ZKK, etj.,
3. Shuma e lejuar, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, OJQ-ja e lartcekur, si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184227  
Më 18.10.2016

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për përkrahje financiare për Qendrën e Strehimit të Grave dhe Fëmijëve, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për Qendrën e Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren, e cila merret me shërbime sociale (strehimin e viktimave të dhunës në familje), kështu që, në emër të këtyre shërbimeve (ushqim, veshmbathje, mjete higjienike, sanitare, etj.), lejohen mjetet financiare në shumën prej 2000 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Qendra e cekur, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184232  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 18 pacientëve, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1. Asllan Durmishi, 2. Feris Xhaferi, 3. Sutjeska Fanaj, 4. Florina Mullafetahu, 5. Aniva Çuçuli, 6. Fejka Aliti, 7. Birsen Paçarizi, 8. Ismet Shaipi, 9. Xhyllfera Murati, 10. Agim Biçaku, 11. Bafti Xhaferi, 12. Mirlinda Krasniqi, 13. Mimoza Pireci, 14. Violeta Pirana, 15. Resmije Kodra, 16. Nehale Bekteshi, 17. Selvete Gorani, dhe 18. Qazim Dadihak.
2. Për këtë qëllim, lejohen mjetet në vlerë prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184236  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me uniforma, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e furnizimit me uniforma për stafin e kujdesit parësor shëndetësor, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt realizohet prej kodit buxhetor-mallra dhe shërbime të kësaj Drejtorie.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184258  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare të Fushatës Kundër Kancerit në Gji, kryetari i Komunës, më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare të Fushatës Kundër Kancerit në Gji, kështu që për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit shpenzimeve rreth kësaj fushate, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Të gjitha femrat e interesuara nga Komuna e Prizrenit, lirohen nga participimi për realizimin e kontrolleve mjekësore në QKMF, me anë të ultrazërit dhe mamografisë gjatë kësaj fushate.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Shëndetësisë-QKMF-ja, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Shëndetësisë-QKMF-ja, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184247  
Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e shpalljes së tenderit për mirëmbajtjen e instalimit elektrik në SHMLE “Ymer Prizreni”, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e mirëmbajtjes së instalimit elektrik-ndriçimit në shkollë e mesme të lartë ekonomike “Ymer Prizreni” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt realizohet prej buxhetit të Komunës së Prizrenit dhe Drejtorisë përkatëse.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-184251

Më 18.10.2016



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit për ndërtimin e objektit të ri të SHM “Lorenc Antoni”, kryetari i Komunës më 18 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e hartimit të projektit për ndërtimin e objektit të ri shkollor të shkollës së muzikës “Lorenc Antoni” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.
2. Ky projekt realizohet prej kodit buxhetor të DKA të planifikuara për këtë qëllim dhe kodeve tjera për hartime të projekteve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184255  
Më 13.10.2016

Në bazë të nenit 13, nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji nr. 03/ L -149, neni 12, paragrafi 4 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e rekrutimit të një (1) nëpunësi për kryerje të shërbimeve të veçanta në Komunën e Prizrenit për kohë të caktuar, kryetari i Komunës, më 13 tetor 2016 miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e rekrutimit të një (1) nëpunësi për kryerje të shërbimeve të veçanta për nevojat e Komunës së Prizrenit, përkatësisht për nevojat e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.
2. Rekrutimi bëhet për kohë të caktuar, përkatësisht në kohëzgjatje për gjashtë (6) muaj, kështu që, lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për rekrutimin dhe pranimin e një (1) nëpunësi për kryerjen e shërbimeve të lartcekura.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Zyra e Personelit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-184281  
Më 20.10.2016

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas ftesës së MAPL-së, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Arben Shala, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 20 tetor 2016, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet ftesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) të datës 18.10.2016, për lejimin e udhëtimit zyrtar për Arben Shalën, koordinator komunal për Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin me temën: “Zbatimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale”, i cili organizohet nga MAPL-ja në bashkëpunim me projektin DEMOS-“Decentralizim dhe Përkrahje Komunave”.
2. Trajnimi do të mbahet nga data 24 tetor 2016 deri me 28 tetor 2016, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja